

VENDIM
Nr.7, datë 25.1.2008

PËR SHFUQIZIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE
NR.11, DATË 23.2.2006, PËR AKTIVITETET E SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SHOQËRINË “KESH” SHA

Në zbatim të nenit 9, nenit 13, pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.862, datë 20.12.2006 “Për krijimin e shoqërisë “OSSH” sh.a. dhe të nenit 15, pika 2 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullores për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.1.2008, pasi shqyrtoi ndryshimin e reflektuar në kuadrin ligjor për strukturën e të licencuarit “KESH” sh.a.,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.11, datë 23.2.2006, në pikën I shfuqizohen pikat 2 dhe 3, në pikën II shfuqizohen pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta